

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQERISE "F.P.M" SHPK.



Me vullnetin e lire te Ortakut te vetem Flamur Mamaj, i biri i Petrefit, i datlindjes 05.07.1964, lindur dhe banues ne Vlore, themelohet Shoqeria Private me pergjegjesi te kufizuar me emrin "F.P.Msh.p.k.

Neni 1

Shoqeria e ka seline e saj ne lagjen "29 Nentori" te qytetit te Vlores, por sipas parashikimeve ne Statut, mund te ngrihet edhe qendra te tjera te dyta, dege, filjale apo agjensi edhe ne vende te tjera.

Neni 2

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete per 15 vjet, por me vendim te Ortakut te vetem dhe sipas parashikimeve ne statut ky afat mund te zgjatet ose shoqeria mund te priset para kohe.

Neni 3

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

Organizimi i sherbimit te rojave civile me detyre per ruajtjen e objekteve ne pronesi ose perdorim te personave juridike e fizike, shqiptare ose te huaj, ruajtjen e rendit ne keto objekte dhe sigurimi i jetes se personalit e te vlerave pasurore te tyre gjate levizjes.

Per kete qellim shoqeria do te kete dhe nje rregullore te brendeshme.

Neni 4

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 100.000 leke. Eshte teresisht kapital financiar dhe i depozituar ne banke ne emer te saj. I tere kapitali themeltar zoterohet nga Ortaku i vetem Flamur Mamaj, i cili ka te drejte te disponoje sipas percaktimeve ne statutin e shoqerise.

Neni 5

Organi drejtues i shoqerise eshte ortakut i vetem, i cili eshte dhe administrator i saj. Kompetencat e tij jane te percaktuara ne statut.

Flamur Mamaj
Flamur Mamaj

Neni 6

Veprimtaria e shoqerise F.P.M"sh.p.k. do te bazohet ne ligjin 7696, date 7.4.1993"per sherbimin e rojave civile",ligjin 7638,date 19.11.1992"per shoqerite tregetare",ne statutin e shoqerise dhe ne legjislacionin ne pergjithsi te Republikes se Shqiperise.

Neni 7

Ky akt themelimi u nenshkrua sot me date .../.../1998.

ORTAKU I VETEM

FLAMUR MAMAJ

Flamur Mamaj

.....
REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA VDRE

Nr. 3102kol.
Nr. 1760rep.
Vlore, me 31./03/1998.

VERTETIM

Me anen e te cilit vertetoj se ortaku i vetem i shoqerise "F.P.M"sh.p.k. Flamur Mamaj, e nenshkroi aktin e themelimit te shoqerise me vullnetin e tij te lire dhe ne pranine time.Pas kesaj une noterja e vertetova dhe e regjistrova.

NOTERJA
XHOZIANA LAZE


PULLE TARRONA
REPUBLIKA E SHQIPERISE
20 LËKË
R.SHQIPERISE



S T A T U T I

I SHOQERISE "F.P.M" shpk.



Neni 1

Eshte themeluar nje Shoqeri private me pergjegjesi te kufizuar me emrin "F.P.Msh.p.k.

Neni 2

Shoqeria e ka seline e saj ne Lagjen "29 Nentori", rruga "Sadik Zotaj", No.959 te qytetit te Vlores. Aparati administrativ, me vendim te Ortakut te Vetem mund te ngreje dëge, filjale apo agjensi edhe ne vende te tjera.

Neni 3

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete per 15 vjet, por me vendim te Ortakut te Vetem dhe sipas parashikimeve ne kete statut, ky afat mund te zgjatet ose shoqeria mund te priset para kohe.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

Organizimi i sherbimit te rojave civile me detyre per ruajtjen e objekteve ne pronesi ose ne perdorim te personave juridike e fizike, shqiptare ose te huaj, ruajtjen e rendit ne keto objekte dhe sigurimin e jetes se personelit e te vlerave pasurore te tyre gjate levizjes, sipas percaktimeve qe behen ne nenin 2 te Ligjit Nr.7696, date 7.4.1993 "Per sherbimin e rojave civile".

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke. Eshte teresisht kapital financiar dhe i depozituar ne banke ne emer te saj.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjese (kuota) me vlere 1.000 leke sejcila kuote.

I gjithë kapitali themeltar i shoqerise zoterohet nga Ortaku i vetem i cili ka te drejte t'a tjetersoje kete kapital, te shtoje apo pakesoje kuotat deri ne kufijte e parashikuar nga ligja.

Neni 6

Organi i vetem drejtues i shoqerise "F.P.M" sh.p.k. eshte Ortaku i vetem, i cili eshte dhe administrator i saj.

Handwritten signature and stamp area.

Neni 7

Ortaku i vetem perfaqeson shoqerine ne mardhenie me te tretet, nenshkruar ne emer te saj te gjitha aktet qe kane te bejne me veprimtarine e shoqerise, ka te drejten e perfaqesimit gjyqesor dhe eshte firme e vetme e shoqerise ne banke.

Neni 8

Kompetencat administrative te ortakut vetem te shoqerise, barazohen me kompetencat qe me ligj i takojne asamblese se ortakave.

Ortaku i vetem i Shoqerise miraton statutin dhe ndryshimet ne te Miraton bilancet

Zgjedh keshillin administrativ.

Vendos per ndarjen e te ardhurave, pjesmarjen ne shoqeri te tjera, shkrirjen e shoqerise para kohe, zgjatjen e afatit minimal te veprimtarise se shoqerise, hapjen e filjaleve te shoqerise ne vende te tjera si dhe per ceshtje te tjera qe me ligj i takojne asamblese se ortakave dhe administratorit.

Neni 9

Ortaku i vetem dhe administratori i shoqerise mund te perfaqesohet nga persona te trete te besuar prej tij, gjithmone brenda kufijve ligjore dhe me prokure te leshuar sipas ligjit.

Funksionet administrative te jashtezakoneshme nuk mund te transferohen

Neni 10

Veprimtaria vjetore e shoqerise mbyllet ne 31 Dhjetor te çdo viti.

Neni 11

Ne perfundim te mbylljes se bilancit ortakut i vetem percakton menyren e shperndarjes se fitimit, likuidimin e detyrimeve dhe percaktimin e rezerves ligjore. Si rregull rezerva ligjore nuk mund te jete me e vogel se 5 per qind e fitimit te realizuar.

Neni 12

Me mbarimin e afatit te caktuar shoqeria shperndahet dhe ortakut i



vetem do te caktoje nje ose disa likujdatore, te cilet, ne baze te ligjit do te realizojne prishjen e shoqerise.

Neni 13

Shoqeria mund te priset para kohe:

1. Me vendim te Ortakut te vetem.
2. Pas dy vjeteve me bilanc negativ te veprimtarise.

Neni 14

E gjithë veprimtaria e shoqerise "F.P.M" sh.p.k. do te bazohet ne ligjin Nr.7696, date 7.4.1993 "Per sherbimin e rojave civile", Ligjin Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" si dhe legjisacionin ne pergjithsi te Republikes se Shqiperise.


Neni 15

Shoqeria "F.P.M" sh.p.k. do te kete vulen dhe siglen e saj.

Ky statut u nenshkrua sot me date .././1998.

ORTAKU I VETEM

FLAMUR MAMAJ



REPUBLIKA E SHQIPERISE
NOTERIA VLORE

Nr. 3102rep.
Nr. 1760kol.
Vlore, me 31/03/1998

VERTETIM

Me anen e te cilit vertetoj se Ortaku i vetem i shoqerise "F.P.M" sh.p.k. Flamur Mamaj e nenshkroi statutin e shoqerise me vullnetin e tij te lire dhe ne pranine time. Pas kesaj une noterja e vertetova dhe e regjistrova.

NOTERJA

